



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 158, datë 18.10.2023

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR DHE
PËRDITËSIMIN E TË DHËNAVE, TË PRONËS, ME EMËRTIMIN:
“PARKIM STACIONI I TRENIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pika 14, nenit 28, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM-së nr.536, datë 01.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, nenit 36, 37, 38, si dhe nenit 39, pika “1.b”, të Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023, “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, Vendimit nr. 500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, Shkresës nr. 1801 prot., datë 15.02.2023, drejtuar ASHK-së Durrës, me lëndë: “Kërkesë për informacion e dokumentacion”, Shkresës nr. 1053/1 prot., datë 27.02.2023, ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Durrës, me lëndë: ‘Kthim përgjigje shkresës nr. 1801 prot., datë 15.02.2023, Shkresës nr. 3843/4 prot., datë 20.7.2023 dërguar ASHK, Durrës, me lëndë”Vazhdim korrespondence”, Shkresë nr. 2576/5 prot., datë 19.9.2023, me lëndë: “Kthim përgjigje në vijim tuajes nr. 3843/4 prot., datë 20.7.2023, Shkresës nr. 7429 prot., datë 07.8.2023, me lëndë: “Kërkesë për informacion”, dërguar Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike pranë bashkisë me lëndë: “Kërkesë për informacion”; Shkresës nr. 7429/1 prot., datë 15.9.2023, dalë nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës

Publike, me lëndë: “Kthim përgjigje”; Shkresës nr. 7136 prot., datë 26.7.2023, drejtuar Ndërmarrjes Rruga, me lëndë: “ Kërkesë për informacion për pas. nr. 4/31, ZK 8514, e llojit “Rrugë”, Shkresës nr. 323/1 prot., datë 01.9.2023, ardhur nga Ndërmarrja Rruga, me lëndë: “Kthim përgjigje shkresës nr. 7136 prot., datë 26.7.2023, Udhëzimit nr. 15, datë 30.06.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, VKM-së nr. 669, datë 07.8.2013, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH) si metadatë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale”, si dhe në vijim të Urdhërit nr. 580, datë 18.11.2022, për përditësimin e pronës me emërtimin: “Parkim tek stacioni i trenit”, në pronësi të Bashkisë Durrës, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe grupi i punës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar të pronës me nr. 208, të listës së transferimit, me emërtimin: “Parkim Stacioni i Trenit”, transferuar në pronësi të Bashkisë Durrës me VKM nr. 536, datë 01.5.2008, sipas lidhjes 01 bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e përditësimit të pronës me emërtimin: “Parkim Stacioni i Trenit”, që mban nr. 208, të listës së transferimit, që përfshin Pasuritë me nr. 4/384, 4/385, 4/28, 4/31, 4/32, 4/27, 4/26, 4/611, ZK 8514, për shkak se gjendja reale (faktike) e pronës, ku përfshihen sipërfaqja, pozicioni, konfigurimi dhe karakteristikat e tjera fizike, nuk përputhen me dokumentacionin e inventarizimit, miratuar me VKM nr. 536, datë 01.05.2008.
3. Miratimin e ndryshimit të zërit kadastral të pasurisë me nr. 4/31, ZK 8514, me sip. 714.62 m², nga lloji “Rrugë”, në zërin kadastral të llojit “truall”, për shkak se provohet se kjo pasuri në asnjë rast nuk ka shërbyer si rrugë, kjo e konfirmuar si nga ballafaqimi me listën e pronave, që i janë transferuar Bashkisë Durrës me VKM nr. 536/2008, dhe konfirmimet e ardhura nga Ndërmarrja Rruga, që i ka në inventar rrugët dhe merret me rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe me Drejtorinë e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike pranë Bashkisë.
4. Miratimin e planrilevimit të pronës me emërtimin: “Parkim Stacioni i Trenit”, i hartuar sipas kërkesave të VKM-së nr.782, datë 07.10.2020, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Miratimin e formularit të përditësimit të pronës me emërtimin: “Parkim i Stacionit të Trenit”, i plotësuar sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe

rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 19.10.2023

Lidhja 1

Bashkia Durrës, Njësia Durrës

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
208	Prona që përdoren për Zhvillim Ekonomik	Në pronësi



1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Identifikoi pronën: Enli Kaculi (ing. gjeodet) *Aleks Prenga* (specialiste) (jurist), (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Ardita Molla (ing. gjeodele) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Per ASHK Durres: Ramonel Tafa (specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Pranvera Gagani (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Elio Jani (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Emiriana Sako (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulg)

Institucioni Qendror Shtetëror /Bashkia: Durres

Fusha e përdorimit të pronës: Prona që përdoren për realizimin e funksioneve ekonomike



Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronat/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera me VKM (Shënime të veçare)
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)				
208	8514 Dr.- JK-67 K-34-99-(I5-D)		Truall	Parking tek Stacioni i trenit Bashkia Durres	4500	4500	471.89	Zhvillim ekonomik	Bashkia Durres	Bashkia Durres	Me VKM 536/2008 ka kaluar ne prones "shesh" 2000 m2 pa numer pasurie
	*	4/384	Truall				471.89				
	*	4/31	Rruge				718.78				
	*	4/32	Shesh				1123				
	*	4/385	Truall				920				
	*	4/28	Truall				154				
	*	4/611	Truall				164				
	*	4/27	Truall				359.78				
	*	4/26	Shesh				588.55				
TOTAL						4500	4500	4500			



Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronat me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI SHTET

DATE 06/10/2023

QELIMI PER TRANSFERIMIN PERFUNDIMTAR

VENDNDODHJA

BASHKIA DURRES, DVASHK DURRES ZONA KADASTRALE 8514 NUMRI I PASURISE 4/384,4/31, 4/32,4/385, 4/28,4/611, 4/26,4/27 INDEKSI I HARTES K-34-90-(15-D)


TË DHËNAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE: TRUALL, RRUGE, SHESH SIPERFAQA E PASURISE = 4500 m2 ZONA KADASTRALE 8514 NUMRI I KATEVE NUMRI I PEMËVE

X 455023.1180
Y 4576042.361

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 455300.9940
Y 4576042.361



X 455023.1180
Y 4575872.1600

SHPJEGUES
KONTURI SIPAS MATJEVE FAKTIKE

SH 1:1000

X 455300.9940
Y 4575872.1600

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V-			150/3		
2	L-			148/2-II		
3	J-			148/3		
....	P-			150/2 ,148/1 ,149/2 ,149/3		

REALIZOI PER BASHKINE DURRES

PUNOI: ARDITA MOLLA ANILA MUHJA
ENLI KACULI

NËNSHKRIMI
PËRGJEGJËS: PRANVERA GAGANI
NËNSHKRIMI
DREJTORI: ELIO JANI
NËNSHKRIMI
KRYETAR: EMIRIANA SAKO
NËNSHKRIMIVULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje

Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;

PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PLAN I RILEVIMIT U HARTUA PER REGJISTRIMIN E PRONËS DUKE U BAZUAR NE VIKM 536 DATË 01.05.2008 "PER MIRATIMIN E LISTËS
E PUNIMEVE KADASTRALE TE PRONAVE TE PALUAJTËSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NE PRONËSI OSE NE PËRDORIM TE BASHKISË
DURRES, TË QARKUT DURRES "I NDORYSHUAR, ME NUMËR LISTE 208 . LIGJI 20/2020 "PER PERFUNDIMIN E PROCEVE KALIMTARE TE
PRONËSISE NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

PASURIA E LLOJIT TRUALL ME NR. : 4/384 DHE SIP.471.89m2, NR.4/385 DHE SIP.920m2, NR.4/28 DHE SIP.154m2, NR.4/611 DHE SIP.164m2, NR.4/27
DHE SIP.18m2,

PASURIA E LLOJIT RRUGE ME NR. : 4/31 DHE SIP.718.78m2,
PASURIA E LLOJIT SHESH ME NR. : 4/32 DHE SIP.1123m2, NR.4/26 DHE SIP.588.55m2.

ME SIPERFAQE TOTALE 4500 m2 SIPAS GJENDJES FAKTIKE DHE PERSHTATUR HTR, DO TI TRANSFEROHET NE PRONËSI BASHKISË DURRES.

PRONARI I PUNIMIT PRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

REALIZOI PER DVASHK


SPECIALISTI: RAMONEL TRIFA

NËNSHKRIMI:

KONFIRMIMI
PËRGJEGJËS/DREJTORI:
NËNSHKRIMIVULA

EMRI
NËNSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash;
P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 666/8 prot.

Durrës, më 24.10.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TËBASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.158 datë 18.10.2023 “Për miratimin e kërkesës për transferimin përfundimtar dhe përditsimin e të dhënave, të pronës, me emërtimin: “Parkim stacioni i trenit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

